

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Tiranë, më datë 14/02 2020 ndërmjet:

1. Avokati i Popullit, përfaqësuar nga **znj. Erinda Ballanca**, adresa: Blv. “Zhan D’Ark”, Nr. 2, Tiranë, Shqipëri.

dhe

2. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përfaqësuar nga **z. Robert Gajda**, adresa: Rruga “Durrësit”, Tiranë, Shqipëri.

dhe

3. Fondacioni Qendra Europiane (në vijim Qendra), përfaqësuar nga Drejtorja Ekzekutive **znj. Ina Xhepa**, adresa: Rr. Vaso Pasha, Pallati 20/57, Tiranë, Shqipëri.

Palët dakordësohen të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi për zhvillimin e një Trajnimi Trajnerësh me stafet e institucioneve respektive, bashkë hostimin dhe prezantimin e platformës së mësimin online mbi “Mbrojtjen nga diskriminimi” në faqet e tyre web.

Në kuadër të projektit “Të drejtat e mia – përmirësimi i njohurive mbi barazinë gjinore nëpërmjet internetit” zbatuar nga Qendra me financim të Fondit Kanadez për Nismat Lokale (CFLI), Qendra synon organizimin dhe zhvillimin e një “Trajnim Trajnerësh”, me stafin e Seksionit të Përgjithshëm të Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Ky aktivitet ka si qëllim rritjen e kapaciteteve të stafit të këtyre institucioneve, si personat që përballen në mënyrë të drejtpërdrejtë gjatë punës së tyre me raste të diskriminimit.

Gjithashtu, Qendra do të hartojë dhe publikojë një platformë e-learning online, e cila do të përmbajë 4 module trajnimi mbi tema të tilla si: mbrojtja nga diskriminimi, barazia gjinore, etika, ndryshimet në legjislacionin civil dhe penal, praktikat më të mira për denoncimin e diskriminimit, etj. Qendra synon bashkëpunimin me Avokatin e Popullit dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi për publikimin e kësaj platforme në faqet web respektive të institucioneve, për një periudhë të pakufizuar, në mënyrë që të arrihet një audiencë më e gjerë dhe qytetarët të kenë mundësi të marrin më shumë informacion rreth tematikave që i prekin.

Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Qendra Europiane, me përfaqësuesit e përmendur më sipër, nënshkruajnë këtë Memorandum Bashkëpunimi, me vullnet të lirë, duke rënë dakord sa më sipër.

Për Avokatin e Popullit


Erinda BALLANCA




Për Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi


Robert GAJDA



Për Fondacionin Qendra Europiane

Ina XHEPA





Prot 275